



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.20

Prishtinë, më 16.5.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Adem Mikullovc, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu dhe Verica Çeraniq.

**Munguan:** Mufera Shinik, Valentina Bunjaku - Rexhepi, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Përfaqësues të tjerë:** Kujtim Gashi-ministër i MKRS, Samir Hoxha e Vjollca Aliu-MKRS, Shafi Gashi e Isuf Koci - KKTK, Rudinë Fetahaj-praktikante dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me gjendjen në Trashëgiminë Kulturore të Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## 2. Diskutim lidhur me gjendjen në Trashëgiminë Kulturore të Kosovës

**Ismajl Kurteshi** tha se arsyeja e këtij takimi është për shkak të informatave që i ka komisioni dhe ankesave të vazhdueshme nga ana e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) për mungesë të bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, përkatësisht Departamentin për Trashëgimi Kulturore dhe që ky takim tenton të mundësojë që bashkëpunimi të fillojë nëse nuk ka ekzistuar ose të rritet nëse nuk ka qenë i mjaftueshëm. Gjithashtu ai shtoi që pasi Këshilli për Trashëgimi Kulturore përfundon mandatin në fund të korrikut 2018, do të duhej të hapej konkursi dhe këtë çështje duhet diskutuar edhe me Ministrin e Kulturës dhe me drejtorin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore.

**Kujtim Gashi**, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, tha se ministria nuk merret me shpalljen e këtij konkursi pasi që është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Shafi Gashi**, drejtor i KKTK-së, tha që Këshilli është institucion vartës i Parlamentit të Kosovës dhe ideja është që të jetë një institucion i pavarur i Parlamentit të Kosovës, i cili ka me qenë një lloj përkrahësi, monitoruesi si dhe të krijojë një pasqyrë të përgjithshme mbi Trashëgiminë Kulturore. Andaj, sipas tij, nuk do të kishte logjikë nëse Ministria e Kulturës të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarët e KKTK. Ai propozoi që e njëjta praktikë si për Këshillin e Pavarur të Mediave, të ndiqet edhe për KKTK.

**Kujtim Gashi** tha që nga muaji shkurt kur ky Inspektorati ka filluar punën, ka bërë 21 inspektime, ndër to ka bërë tri kallëzime penale për dëmtim të trashëgimisë në vend. Ministri po ashtu u shpreh se MKRS ka përgatitur koncept-dokumentin për ligjin për trashëgiminë kulturore i cili do të procedohet në Kuvend. Ministri theksoi se ka filluar zbatimin e programit për trashëgiminë sidomos në plotësimin e legjislacionit dhe se MKRS ka rritur buxhetin për trashëgimi, ku vetëm në vitin 2018 buxheti pa pasur rritje afro 30% e që i bie afërsisht 1 milion euro, krahasuar me vitin 2017. Ministri tha që prioritet ka qenë themelimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, një detyrim ligjor ky i pa përmbushur për më shumë se një dekadë. Gjithashtu ai tha që bazuar në programin e punës në MKRS, trashëgimia kulturore ka pasur një vëmendje të kushtuar dhe përbën një nga sfidat kryesore të kësaj ministrie. Janë realizuar 12 projekte në ndërtesat me status të mbrojtjes, kurse të kërkimet në kuadër të trashëgimisë arkeologjike janë realizuar 19 projekte. Ministri ka njoftuar anëtarët e komisionit edhe për përgatitjen e materialeve e dokumenteve të trashëgimisë kulturore, ku janë cekur 10 botime të realizuar. Ndërkaq ai shtoi që në kuadër të politikave programore i është kushtuar 14 projekteve në trashëgiminë shpirtërore.

**Ismajl Kurteshi** shtroi pyetjen se “Në kalanë e Novobërdës punon një kompani e Beogradit që 3-4 vite dhe me aq sa jam i informuar, atë askush nuk e monitoron. Cila është qasja juaj, a keni

informata se çka po ndodh atje apo atje po punohet ashtu siç po ua merr mendja? E di që atë projekt janë shpenzuar rreth 4 milionë euro”.

**Vjollca Aliu**, drejtoreshë e Departamentit për Trashëgimi Kulturorë në Ministrinë e Kulturës, tha që projekti për kalanë e Novobërdës është negociuar në periudhën e vitit 2012/2013 ndërmjet MKRS dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe si mbështetës shtesë ka qenë Ministria e Planifikimit Hapësinor, meqë ajo është zonë e veçantë e mbrojtur, si dhe është bashkë financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në kuadër të fondit të IPA. Ajo tha që edhe MKRS e ka mbështetur me buxhet çdo vit këtë projekt dhe se shuma e këtij projekti, sa i përket trashëgimisë, është afërsisht 1 milion euro, pasi që preket fusha e zhvillimit rural dhe turizmit kulturorë, pra 3 komponentë në një projekt. Ndërsa sa i përket punë kryerësit, Vjollca Aliu tha që është zgjedhur një kompani që ka fituar punën përmes procedurave të prokurimit dhe tenderimit që i ka zhvilluar zyra e UNESCO-s, fillimisht në Venedik, e mandej edhe në Sarajevë, duke potencuar faktin që MKRS nuk ka qenë pjesë e asaj procedure. Ajo shtoi që projekti është hartuar nga një kompani e Zagrebit të Kroacisë, kurse punimet janë përfunduar nga një punë kryerës nga Beogradi.

**Ismajl Kurteshi** bëri replikë me Vjollca Aliun duke i thënë që ju keni hequr dorë si institucion, si Qeveri e vendit dhe keni lejuar që dikush tjetër të përzgjedhë kompaninë, e cila nuk e ka besueshmërinë politike të këtij vendi. Ai tha që kjo është një përgjegjësi tepër e madhe që ju, si ministri, të lejoni kesi lloj gjërash.

**Vjollca Aliu** tha që ka qenë një natyrë krejt tjetër e projekteve dhe IPA ka rregulla të tjera, përndryshe pjesa e kulturës dhe trashëgimisë kulturore nuk trajtohet si komponent e veçantë në këto projekte, por nën kohezionin social, ndaj ka qenë vendimi i tillë që të procedohet kështu. Ajo gjithashtu tha se edhe pse kemi bashkëpunuar me UNESCO-n, nuk jemi përfshirë në procedurat e përzgjedhjes.

**Ismajl Kurteshi** tha që prapëseprapë kjo nuk e arsyeton faktin që një organizatë e cila nuk na ka pranuar neve si shtet, të marrë përsipër një projekt dhe të mos përfshijë institucionet tona.

**Kujtim Gashi** tha që ky është një projekt i trashëguar, për mënyrën dhe formën që është proceduar, nuk kam pasur informata, si dhe premtoi që deri në takimin e ardhshëm do ta marrë përsipër që të hulumtojë më shumë lidhur me këtë projekt.

**Teuta Haxhiu** tha që qarkullojnë lajme që në atë kala edhe të hyrat merren nga individë të caktuar dhe keqpërdorin buxhetin. Ajo shtroi pyetjen për Kullën e Sylejman Vokshit në Gjakovë duke e potencuar si shqetësim të vazhdueshëm të qytetarëve.

**Vjollca Aliu** iu përgjigj pyetjes së Teuta Haxhiut duke thënë që edhe në vitin 2012/2013 kemi pasur shumë përpjekje për të ndërhyrë dhe konsoliduar ndërtesën e kullës së Sylejman Vokshit, mirëpo nuk kemi hasur në mirëkuptimin e pronarëve dhe bashkëpronarëve. Ajo tha që është bërë kërkesa për shpronësimin e kullës në Komunën e Gjakovës dhe drejtori Luan Dini tha se do t’ i marrë të gjitha masat për largimin e njerëzve dhe për t’ i hap rrugë restaurimit, si dhe që janë në koordinim me drejtoritë komunale të Gjakovës.

**Nezir Çoçaj** tha se ishte shumë i shqetësuar nga raportimi i drejtorit të Këshillit lidhur me mosbashkëpunimin dhe mospërfilljen e Këshillit nga ana e MKRS, përkatësisht Departamentit për Trashëgimi Kulturorë në dërgimin e dokumenteve, si dhe në shqyrtimin / këshillimin mbi projekte të ndryshme. Ai tha se është obligim i yni të shohim nga afër mënyrën e funksionimit të këtij këshilli. Gjithashtu, ai shtoi se është obligim i Komisionit dhe Ministrisë që ta ndihmojë këtë Këshill, si dhe të përfillen këshillat dhe sugjerimet e tyre.

**Isuf Koci**, udhëheqës ekzekutiv i KKTK, e cilësoi mungesën e bashkëpunimit në mes të MKRS dhe KKTK si problem kronologjik dhe jo vetëm aktual. Ai tha që ky mosbashkëpunim vjen si pasojë e mosrespektimit të ligjit për Trashëgimi Kulturorë nga ana e Ministrisë. Mos vlerësimi i projekteve nga Këshilli sipas mandatit është pikënisja e problemeve që po rrjedhin në mes të Ministrisë së Kulturës dhe Këshillit. Ai tha se me nenin 5.2 të ligjit, ministria obligohet që të kërkojë vlerësimin e projekteve nga ana e Këshillit, mirëpo që ky nen nuk është respektuar pasi që nga viti 2009, Këshilli nuk ka vlerësuar asnjë projekt. Pjesë tjetër të ligjit që u potencua nga ana e Isuf Kocit ishte neni 4.9 i cili përcakton që “prioritetet financiare për Trashëgimi Kulturorë caktohen nga Këshilli, mirëpo edhe përkundër faktit që vitin e kaluar Këshilli ka përpiluar një listë të prioriteteve të cilën e kanë dërguar në Kuvend, ajo listë ka mbetur e pa trajtuar. Ndërsa sa i përket këtij viti, ai tha se lista është hartuar dhe që do bëhet organizimi i një punëtorie me të gjitha institucionet përkatëse të Trashëgimisë Kulturorë për të caktuar prioritetet e kësaj fushe.

Isuf Koci, shtoi që ministria nuk po përmbush as obligimet praktike. Ai tha që në vitin 2016 për herë të parë ministria ka dërguar në Këshill një listë për mbrojtje të përhershme të aseteve e që me ligj përcaktohet që ministria propozon këtë listë ndërsa Këshilli miraton ose refuzon. Si pasojë e mungesës së dokumentacionit nga ana e ministrisë në këtë listë, Këshilli ka shpallur vetëm 23 asete për mbrojtje të përhershme, ku 14 prej tyre i takojnë trashëgimisë arkitekturale, kurse të tjerat trashëgimisë arkeologjike. Përpos kësaj, ai shtoi se, në momentin e miratimit të këtyre aseteve, ministria obligohet që brenda afatit 6 mujor të hartojë planet e menaxhimit të këtyre aseteve, obligim që Ministria nuk ka arritur të përmbushë si pasojë e mosbashkëpunimit. Gjithashtu, ai tha që, Kosova ka mjaftueshëm legjislacion dhe strategji të miratuara, andaj mungesa e ligjit ose paqartësive në ligj nuk e justifikojnë shkatërrimin e Trashëgimisë Kulturorë, por është mungesa e respektimit të ligjit që ka sjellë këto probleme.

**Vjollca Aliu** tha që është e befasuar për vërejtjet e marra nga ana e Këshillit, sepse ministria nuk ka pasur asnjëherë përpjekje për mosbashkëpunim. Ajo tha që Këshilli, që nga koha kur është themeluar, nuk ka qenë gjithmonë në funksion të plotë.

Sa i përket vlerësimit të projekteve, ajo tha që duhet të ndryshohet forma e procedimit të planeve të punës dhe që si mekanizma shtesë, ekzistojnë edhe këshillat drejtues të 3 institucioneve qendrore dhe që pa rekomandimet e tyre, ministria nuk lëviz tutje. Në anën tjetër, mosdorëzimi i listës deri në vitin 2016, ajo e arsyetoi me faktin që Këshilli nuk ka qenë në funksion të plotë mirëpo që gjithmonë është konsideruar dhe trajtuar si një mekanizëm tejet i rëndësishëm.

Gjithashtu, ajo tha që kanë pritur gjatë për përgjigje nga ana e Këshillit për çështjen e dosjeve si dhe potencoi faktin që kryetari Gashi ka qenë në dijeni që kjo përgjegjësi është bartur tek institucionet e tjera që janë duke punuar aktualisht. Për planet e menaxhimit, Vjollca Aliu tha që janë shumë të rëndësishme, por jo edhe obliguese. Ne vetë, si ministri, i shohim si të rëndësishme dhe që secili plan i menaxhimit ka pasur edhe asistencë ndërkombëtare, përjashtuar planin për Qendrën Historike të Prizrenit i cili është në procedurën përfundimtare nga ministria në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Ajo tha që mbrojtja e përhershme nuk është vetëm prioritetet e Ministrisë dhe Këshillit, por i gjithë shtetit dhe aty ku duhet, do të jemi në përmbushje të detyrave dhe mbështetje të Këshillit ashtu siç kemi qene deri tash.

**Ismajl Kurteshi** tha që sipas përfaqësues së ministrisë, bashkëpunimi është në nivel, kurse sipas Këshillit ka pasur shumë ankesa.

**Isuf Koci** tha që sa i përket çështjes së projekteve, deri më sot asnjë projekt nuk ka ardhur në Këshill për vlerësim dhe vlerësohen nga një trup i krijuar nga ministri, e që sipas ligjit duhet të vlerësohen nga Këshilli, e që ligji nuk po zbatohen.

**Kujtim Gashi** tha që nuk duhet të fokusohemi te çështja e projekteve për vlerësim, sepse funksionimi i këtij Këshilli është zero, edhe në departament ka defekte shumë, por po mendoj që të gjitha problemet e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë janë si pasojë e mosfunksionimit të këtij Këshilli dhe kjo është arsyeja e themelimit të Inspektoratit për Trashëgimi Kulturore dhe që me ligjin e ri duhet të përcaktohet se a do të ekzistojë më tutje ky Këshill apo do të ketë mekanizma tjerë.

**Shafi Gashi** tha se ajo çfarë kërkon Këshilli është vetëm ajo që parashihet me ligj dhe që nga momenti kur është funksionalizuar Këshilli e deri tash, nuk ka ndodhur kjo gjë nga ana e Ministrisë. Trashëgimia arkeologjike është e vërtetë që ka një buxhet të konsoliduar për të cilën e falënderoi ministrinë për këtë mbështetje, por tha që ky buxhet nuk mjafton. Ai tha që kemi kapacitete për të ndërtuar edhe ekspozita të mira por që kjo punë nuk bëhet për 1 muaj. Ndërsa sa i përket botimeve, ai tha që në pamje të parë duken shumë kualitative, por brumi që është brenda atyre botimeve është jashtë pretendimeve të stafit profesional dhe që kjo ndodh sepse nuk kalohet në filtrat e duhur, shtoi ai.

Ai theksoi edhe problemin mbi prezantimin e punës arkeologjike dhe arkitekturore e cila duhet prezantuar para një paneli shkencor, mirëpo që për shkak të pengesave teknike, Këshilli nuk arrin të prezantojë të gjeturat në terren. Gjithashtu, ai potencoi nevojën që ka ky këshill për stafin profesional që vjen si pasojë e mungesës së buxhetit të mjaftueshëm. Ai tha që ministria shfaq mos respekt për stafin profesional me pagat aktuale që i kanë, e që janë më të ulëta se të një mësuesi të ciklit fillor të ulët.

**Ismajl Kurteshi** e pyeti Shafi Gashin se a ka kërkuar ndonjëherë takim më ministrin ose me drejtoreshën e Departamentit dhe jeni refuzuar, sepse ky debat është dashur të zhvillohet mes

juve dy palëve, mirëpo për shkak të mosbashkëpunimit ndërmjet MKRS dhe KKTK ka pësuar kultura dhe trashëgimia dhe jemi detyruar si komision të ju dëgjojmë juve. Ai tha se komisioni ka themeluar një grup punues për mbikëqyrjen e implementimit të ligjit për Trashëgimi Kulturore dhe do të shihet sa është respektuar ligji dhe nga kush, si dhe ata që nuk e kanë respektuar këtë ligj, do të propozojmë masa.

**Adem Mikullovc**i tha që sa i përket prioriteteve të aseteve, kush i cakton prioritetet, Ministria apo Këshilli sepse pika më e dobët është trashëgimia kulturore në të cilën janë futur sofa e Pejës e që sipas tij është vetëm rezultat i zhvillimit muzikor kohëve të fundit. Ai gjithashtu tha që, Xhemajl Obria nuk mund të konsiderohet trashëgimi shpirtërore, por Anton Çeta që ka bërë përmbledhjen e plotë.

**Nezir Çoçaj** tha se të dy palët do të duhej të ishin më konkret në këtë punë. Ai tha se bashkëpunimi duhet të ekzistojë patjetër mes të Ministrisë dhe Këshillit si dhe duhet të ketë zbatim të ligjit nga ana e ministrisë, pra të kërkojë mendimin e Këshillit për projektet e propozuara. Ai shtoi se nëse Ministria i ndihmon Këshillit, atëherë po ndihmon trashëgiminë kulturore të të gjithë Kosovës.

Verica Ceraniq, në diskutimin e saj kërkoi sqarim lidhur me dëmët e shkaktuar në monumentet e kultit ortodoksë në trazirat e marsit të 2004, pastaj kërkoi sqarim lidhur me procedurat rreth restaurimit të manastirit të Prizrenit. Lidhur me Manastirin e Deçanit kërkoi sqarim se a do të ketë shpallje publike për ndërtim të rrugës, ndërsa sa i përket hartimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturore, kërkoi sqarim nga ministri se a do të ketë përfaqësues nga komuniteti serb në këtë grup punues.

**Ismajl Kurteshi** tha që komisioni ka formuar një grup punues vetëm për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, e jo për hartimin e ligjit.

**Kujtim Gashi**, sa i përket çështjes së Shën Angjelit, aty ka një vendim të komisionit sepse ministri nuk merr vendime për çështje të tilla, por komisioni profesional, ndërsa lejen për ndërtim e japin komunitat. Kurse sa i përket rrugës së Deçanit, për Manastir, është diskutuar në këshillin për monitorim dhe zbatim. Sa i përket bashkëpunimeve, ai tha se me gjithë palët që kërkojnë takim, unë zotohem që të i përmbush kërkesat e tyre, andaj është befasuese edhe ankesa e kryetarit të Këshillit sepse unë me të takohem edhe jo formalisht. Ai premtoi që do të ketë bashkëpunim në mes të Ministrisë dhe Këshillit në përmbushjen e kërkesave për projekte, mirëpo që nuk duhet manifestuar inate personale dhe të ketë koordinim të duhur dhe përgjigjet nga ministri, Këshilli t' i kryejë me kohë. Ndërsa sa i përket prioriteteve të aseteve, caktohen kryesisht nga institucionet vartëse të MKRS dhe lista propozohet nga qendrat rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

**Teuta Haxhiu** tha që si përfundim i këtij diskutimi, po del që problemet kanë qenë mes vete te Këshilli dhe mos koordinim të punëve të tyre. Ajo gjithashtu shtoi që as Këshilli e as Departamenti nuk kanë thënë diçka të vlefshme në këtë takim sa i përket problemeve për të cilat kanë qenë të ftuar, përpos ministrit, që ajo e konsideroi shumë korrekt dhe praktik. Ajo tha që

është shndërruar në praktikë që Këshilli të dërgojë gjithmonë raporte përshkruese dhe jo të sjellë diçka të re dhe konkrete. Në anën tjetër, Teuta Haxhiu tha që nuk janë në interes të komisionit bisedat joformale në mes të Ministrisë dhe Këshillit, mirëpo janë shkresat zyrtare ato që duhet evidentuar dhe arsyetuar. Ajo potencoi që vërejtje ka për të dy palët dhe me këto ankesa nuk është e qartë roli i Këshillit dhe Departamentit, si dhe theksoi që është shumë e zhgënjyer nga puna e Këshillit dhe mosrespektimi i ligjit nga ana e Departamentit. Në fund ajo shtoi që inatet personale duhet lënë anash dhe problemi i mosbashkëpunimit nuk duhet të ekzistojë asnjëherë në mes të këtyre dy institucioneve.

**Fidan Rekaliu** tha duhet të punohet me më intensitet për Trashëgiminë Kulturore, si dhe të rritet bashkëpunimi në mes të dy institucioneve përkatëse.

**Ismajl Kurteshi** tha se është obligim bashkëpunimi në mes vete dhe që duhet raportuar me kohë çdo problem që keni. Ai gjithashtu tha se duhet respektuar ligjet sepse e kemi për obligim.

### **3. Të ndryshme**

Për këtë pikët të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i komisionit.*

**Kryetari i komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**